

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar i Avancuar**

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 21.01.2023

1. Pasqyrat financiare të konsoliduara në vijim kanë të bëjnë me Bhutto sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022.

**Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor**

	<b>2022</b>	<b>2021</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluse</i>		
Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet	1,600	1,400
Zëri i mirë	176	180
Investimet në ortakëri	284	300
Tatimi i shtyrë	<u>-</u>	<u>20</u>
	2,060	1,900
<i>Pasuritë qarkulluse</i>		
Stoqet	200	172
Të arkëtueshmet tregtare	280	292
Paraja & ekuivalentët e parasë	-	<u>26</u>
	480	490
<b>Total pasuritë</b>	<b>2,540</b>	<b>2,390</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e ekuitetit prej €0.50 secila	660	440
Premia e aksioneve	132	32
Fitimet e mbajtura	<u>(18)</u>	<u>(48)</u>
	774	424
Interesat jo-kontrollues	<u>254</u>	<u>232</u>
Total ekuiteti	1,028	656
<i>Detyrimet</i>		
Afatgjatë		
Përfitimet e punonjësve	448	596
Tatimi i shtyrë	34	-
20% Notë krediti	<u>464</u>	<u>680</u>
	946	1,276
Afatshkurtë		
Të pagueshmet tregtare	260	268
Tatimi	58	94
Kosto financiare e pagueshme	160	96
Mbitërheqja bankare	<u>88</u>	<u>-</u>
	566	458
Total detyrimet	<u>1,512</u>	<u>1,734</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>2,540</b>	<b>2,390</b>

## Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

	€'000
Të hyrat	2,360
Kosto e shitjes	<u>(884)</u>
Fitimi bruto	1,476
Të ardhurat tjera	40
Kosto e shpërndarjes	(666)
Kosto administrative	(530)
Kosto financiare	(90)
Pjesa e humbjes së ortakërisë	<u>(120)</u>
Fitimi para tatimit	110
Tatimi	<u>(44)</u>
<b>Fitmi për periudhën</b>	<b>66</b>
<i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</i>	
Neto fitimet sipas ekspertëve të vlerësimit	<u>8</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>74</b>
Fitimi i periudhës i atribuar tek:	
Mbajtësit e ekuitetit të prindit	52.8
Interesit jo-kontrollues	<u>13.2</u>
	66.00
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse atribuar tek:	
Mbajtësit e ekuitetit të prindit	<u>60.80</u>
Interesit jo-kontrollues	<u>13.20</u>
	74.00

### Informata në vijim janë të rëndësishme:

- (i) Zhvlerësimi për vitin ishte €136,000. Kjo u ngarkua me koston e shitjeve. Më tej, fitimi nga shitja e pajisjeve u transferua në të ardhura të tjera ndërsa humbja nga shitja e impiantit u ngarkua me koston administrative. (shih shënimin vii)
- (ii) Me 31 dhjetor 2022, Bhutto sh.a bleu 80% të aksioneve të kapitalit të Yousafzai sh.a për një shumë prej €252,000. Vlera e drejtë e pasurive neto të Yousafzai sh.a në blerje ishte €28,000. Kjo është përmbledhur më poshtë:

	€'000
Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet	27.20
Të arkëtueshmet tregtare	3.40
Banka	2.40
Të pagueshmet tregtare	(4.00)
Tatimi	<u>(1.00)</u>
	<b>28.00</b>

Nuk ka pasur shitje të filialit gjatë vitit deri më 31 dhjetor.

- (iii) Është politikë e grupit të Bhutto sh.a që të vlerësojë interesat jo kontrolluese duke përdorur metodën proporcionale të pasurive neto.
- (iv) Zëri i mirë i konsoliduar dhe investimi në ortakëri u dëmtuan gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2022, me përjashtim të emrit të mirë në Parks sh.a.

- (v) Bhutto sh.a bleu shtesë 10% të aksioneve të ekuitetit në Parks sh.a për një shumë prej €28,000 në para më 31 dhjetor 2022. Kjo rriti aksionet e saj në 80%. Bhutto sh.a bleu 70% të aksioneve të ekuitetit në Parks sh.a më 1 janar 2020 për një shumë prej €178,000. Vlera e drejtë e pasurive neto të Parks sh.a ishte €260,000 dhe €220,000 me 31 dhjetor 2022 dhe 1 janar 2020 respektivisht. Zëri i mirë në Parks sh.a nuk ishte dëmtuar që nga blerja e tij. Lëvizja në ekuitet nga ky transaksion u dërgua në preminë e aksioneve.
- (vi) Bhutto sh.a bleu 25% të aksioneve të ekuitetit në Kahlo sh.a më 1 qershor 2022 për një shumë prej €144,000. Bhutto sh.a ka ndikim domëthënës në Kahlo sh.a. Bhutto sh.a mori dividendë totale prej €16,000 nga të gjitha kompanitë e saj të lidhura për vitin deri më 31 dhjetor 2022. Asnjë investim në kompanitë e lidhura nuk u shit gjatë vitit.
- (vii) Me 30 tetor 2022, Bhutto sha ka shitur pajisjet me vlerë bartëse prej €76,000 për €116,000 para të gatshme. Më 1 nëntor 2022, Bhutto sh.a shiti një pjesë të impiantit për €12,000 në para. Kjo kishte një vlerë bartëse prej €14,000.
- (viii) Bhutto sh.a prezantoi planin e përfitimeve të përcaktuara më 1 janar 2020. Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2022, ka paguar kontribute pensionale prej €200,000. Asnjë përfitim pensional nuk është paguar gjatë vitit. Shpenzimet neto të pensioneve janë ngarkuar në shpenzimet administrative. Fitimet neto nga vlerësimet e ekspertëve u regjistruan në preminë e aksioneve.
- (ix) Nota e kreditit 20% u emetua më 1 janar 2021. Ajo ishte klasifikuar saktë si “detyrim financiar nëpërmjet fitimit ose humbjes”. Të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë u regjistruan në shpenzime administrative. Nuk ka pasur asnjë blerje apo shitje të ndonjë detyrimi financiar të klasifikuar si 'përmes fitimit ose humbjes' gjatë vitit.
- (x) Bhutto sh.a emetoi aksione të ekuitetit për para me 31 korrik 2022. Për më tepër, Bhutto sh.a, dhe kompanitë e saj filiale dhe ortakëritë paguan dividendat me 1 korrik 2022.

**Kërkohet:**

**Përgatite një pasqyrë të konsoliduar të rrjedhës së parasë për grupin Bhutto sh.a duke përdorur metodën indirekte për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 në pajtim me kërkesat e SNK 7 Pasqyra e rrjedhjeve të parasë së gatshme. (30 pikë)**

## Grupi Bhutto

### Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjeve të parasë së gatshme për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

	€'000
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operacionale</i>	
Fitimi para tatimit:	110.00
Pjesa e humbjes së ortakërisë	120.00
Kosto financiare	90.00
Zhvlerësimi	136.00
Neto shpenzimet e pensioneve L19	60.00
Humbja në shitjen e impiantit (12 -14)	2.00
Fitim në shitjen e paisjes (116 -76)	(40.00)
Rënia në vlerën e drejtë të notës së kreditit (680 - 464)	(216.00)
Dëmtimi i zërit të mirë L12	233.60
Rritja në stoqe (200 - 172)	(28.00)
Rënia në të arkëtueshmet tregtare (280 -292 - 3.4 )	15.40
Rënia në të pagueshmet tregtare (260 - 268 - 4)	<u>(12.00)</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet	471
Kontributet e pensioneve të paguara	(200.00)
Tatimi i paguar L14	(27.00)
Interesi i paguar L110	<u>(26.00)</u>
<b>Neto Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operacionale</b>	<b>218.00</b>
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet e investimit</i>	
Blerja e Yousafzai sh.a (252 - 2.4)	(249.60)
Blerja e aksoneve në Parks sh.a	(28.00)
Blerja e aksoneve në Kahlo sh.a	(144.00)
Blerja e PP.ImP.P L11	(398.80)
Arkëtimet nga shitja e PP.ImP.P (116+12)	128.00
Dividendat e arkëtuara nga ortakëritë	<u>40.00</u>
<b>Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet e investimit</b>	<b>(652.40)</b>
<i>Rrjedhat e parasë nga aktivitetet e financimit</i>	
Arkëtimet nga emetimi i aksioneve L16	314.00
Paraja e pranuar nga IJK L18	29.20
Dividendët tjerë të paguar L17	<u>(22.80)</u>
<b>Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet e financimit</b>	<b>320.40</b>
Zvogëlimi në para & ekuivalentë të parasë	(114.00)
Paraja & ekuivalentë të parasë në fillim	<u>26.00</u>
Paraja & ekuivalentë të parasë në fund	(88.00)

**Llogaritjet:**

<b>L11 Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	1,400.00
Zhvlerësimi	(136.00)
Filiali i ri	27.20
Shitjet (76+14)	(90.00)
Blerjet (saldo balancuese)	<u>398.80</u>
Saldo në fund	1,600.00
<b>L12 Zëri i mirë</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	180.00
Filiali i ri 252 - (80% x 28)	229.60
Dëmtimi (saldo balancuese)	<u>(233.60)</u>
Saldo në fund	176.00
<b>L13 Investimi në ortakëri</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	300.00
Blerjet	144.00
Pjesa e humbjeve	(120.00)
Shitjet	-
Dividendat e pranuar	<u>(40.00)</u>
Saldo në fund	284.00
<b>L14 Tatimi</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim (94 - 20)	74.00
Fitim ose humbje	44.00
Filiali i ri	1.00
Paraja e paguar (saldo balancuese)	<u>(27.00)</u>
Saldo në fund (58+34)	92.00
<b>L15 Levizjet në ekuitet - 10% pronësi të aksioneve</b>	<b>€'000</b>
IJK me at 31 dhjetor 2022 para shitjes (30% x 2,600)	78.00
Zvogëlimi në IJK 10/30 x 78	26.00
Konsiderata e paguar	<u>28.00</u>
Levizjet negative në ekuitet	(2.00)
<b>L16 Emetimi i aksioneve</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim (440 + 32)	472.00
Neto fitimet sipas ekspertëve të vlerësimit	8.00
Aksionet e emetuara për para (saldo balancuese)	314.00
Levizjet në ekuitet L15	<u>(2.00)</u>
Saldo në fund (660 + 132)	792.00
<b>L17 Fitimet e mbajtura</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	(48.00)
Fitim ose humbje	52.80
Dividendat e paguara (saldo balancuese)	<u>(22.80)</u>
Saldo në fund	(18.00)

<b>L18 Interesi jo-kontrollues</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	232.00
Filiali i ri 20% x 28	5.60
Fitim ose humbje	13.20
Zvogëlimi në IJK L15	(26.00)
Paraja e pranuar (saldo balancuese)	<u>29.20</u>
Saldo në fund	254.00
<b>L19 Përfitimet e punonjësve</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	596.00
Neto fitimet sipas ekspertëve të vlerësimit	(8.00)
Neto shpenzimet e pensioneve (saldo balancuese)	60.00
Kontributet e paguara	<u>(200.00)</u>
Saldo në fund	448.00
<b>L110 Interesi i pagueshëm</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	96.00
Fitim ose humbje	90.00
Paraja e paguar (saldo balancuese)	<u>(26.00)</u>
Saldo në fund	160.00

2.

a) Coco sh.a është kompania prind e një grupi kompanish të listuara shumëkombëshe. Coco sh.a përdor USD (\$) si valutën e saj funksionale. Coco sh.a së fundi bleu 80% të aksioneve të aksioneve të Chanel sh.a, një kompani e vendosur në Republikën e Kosovës më 1 janar 2022. Vitit financiar aktual i grupit përfundon me 31 dhjetor 2022.

Zyra qendrore e Chanel sh.a ndodhet në Prishtinë e cila përdor EUR (€) si valutë kryesore. Megjithatë, stafi i saj është i shpërndarë në vende të ndryshme. Për rrjedhojë, gjysma e stafit paguhet në EUR dhe gjysma tjetër në USD. Chanel sh.a ka një shkallë të lartë autonomie dhe nuk mbështetet në financim nga Coco sh.a, dhe as shitjet ndaj Coco sh.a nuk përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tyre. Të gjitha shitjet dhe blerjet e saj janë të faturuara në EUR dhe për këtë arsye Chanel sh.a mbledh pjesën më të madhe të financave të saj në EUR. Arkëtimet e parave të gatshme bëhen në EUR. Chanel sh.a nuk ka ndonjë llogari bankare në USD. Chanel sh.a-së i kërkohet me ligj të paguajë tatimin mbi fitimet e saj në EUR.

**Kërkohet:**

**Në përputhje me SNK 21 Efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të valutës së huaj, shpjegoni drejtorëve të Coco sh.a, se si duhet të përcaktohet valuta funksionale e Chanel sh.a. (5 pikë)**

b) Sipas SNRF 3 të rishikuar një kombinim në biznes ndodh vetëm kur një entitet merr kontrollin e entitetit tjetër, që në përgjithësi është 50% apo më shumë.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni implikimin e konsolidimit të një ndryshimi në strukturën e grupit që nuk rezulton në humbjen e kontrollit. (5 pikë)**



**a)**

Në përputhje me SNK 21, valuta funksionale është valuta e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon entiteti. Me një blerje të entitetit në vend të huaj, duhet të merret parasysh nëse Chanel sh.a duhet të adoptojë të njëjtën valutë funksionale si kompania prind e saj, Coco sh.a. Megjithatë, Chanel sh.a duket se është kryesisht e pavarur dhe nuk varet nga Coco sh.a as për shitje, as për financa. Prandaj, nuk kërkohet që Chanel sh.a të adoptojë të njëjtën valutë funksionale si Coco sh.a, e cila në këtë rast është USD (\$). Chanel sh.a nuk duket të ketë transaksione në USD ose të ketë një llogari bankare në USD dhe mund të konkludohet se USD nuk duhet të jetë valuta e tyre funksionale.

Në përcaktimin e valutës së saj funksionale, Chanel sh.a duhet të marrë parasysh valutën që ndikon kryesisht në çmimin e saj të shitjes së mallrave dhe valutën që ndikon kryesisht në kostot e saj të punës dhe të tjera. Kjo ka të ngjarë të jetë valuta në të cilën faturohen mallrat dhe valuta në të cilën paguhen kostot. Vendndodhja e zyrës qendrore të entitetit është e parëndësishme, përveç në masën që ka të ngjarë që kostot e menaxhimit të zyrës qendrore të paguhen në valutën vendase. Për Chanel sh.a, duket se shumica dërrmuese e transaksioneve të tyre janë në EUR. Të gjitha shitjet dhe blerjet faturohen në EUR, si dhe afërsisht gjysma e stafit të tyre paguhet në EUR. Fondet për financa janë mbledhur në EUR gjë që sugjeron më tej që EUR duhet të zgjidhet si valuta funksionale e Chanel sh.a.

**b)**

Implikimet e mëposhtme kontabël duhet të vihen re kur një IJK në një filial ndryshon, por kompania prind ruan kontrollin:

- Një rritje ose zvogëlim në interesin kontrollues kur kontrolli është mbajtur kontabilizohet sipas SNRF 3 të rishikuar si një transksion ndërmjet pronarve. Diferenca ndërmjet konsideratës dhe ndryshimit në interesin jo-kontrollues tregohet si një korrigjim në ekuitetin e prindit.
- asnjë fitim ose humbje nuk njihet kur kompania prind shet aksione (pra IJK në rritje)
- blerja nga një kompani prind e aksioneve shtesë në filialin (duke zvogëluar IJK) nuk rezulton në emër të mirë shtesë ose rregullime të tjera në kontabilitetin fillestar për kombinimin e biznesit
- në të dyja situatat, vlera kontabël e ekuitetit të kompanisë dhe pjesa e kapitalit të IJK-së rregullohet për të pasqyruar ndryshimet në interesin e tyre relativ të pronësisë në filialin. Çdo diferencë midis shumës së rregullimit të IJK dhe vlerës së drejtë të shumës së marrë ose të paguar njihet në ekuitet, që i atribuohet kompanisë prind.

3.

(a) Hepburn sh.a operon një skemë të pensioneve me përfitime të përcaktuara e cila më 31 dhjetor 2021 ishte me deficit prej €120 milionë. Detajet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	<b>€'milionë</b>
Kostot aktuale të shërbimit	55
Kontributet në para të pranuar	100
Përfitimet e paguara gjatë vitit	80
Neto humbja nga zvogëlimi i planit	11
Fitimi në rimatjen e detyrimit me 31 dhjetor 2022	9

Norma e interesit e aplikueshme për obligacionet e korporatave ishte 5% dhe 8% në 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2022 respektivisht. Kontributet në para për skemën janë llogaritur saktë në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022. Ky është i vetmi rregullim që është bërë në lidhje me skemën e pensioneve.

**Kërkohe:**

**Rekomandoni trajtimin e saktë kontabël të transaksioneve të mësipërme për drejtorët e Hepburn sh.a në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, duke përfshirë ekstraktet e pasqyrave financiare në përputhje me SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*. (5 pikë)**

(b) Banka Zhvillimore sh.a është një bankë e kontrolluar nga qeveria. Banka Zhvillimore sh.a u mor nga qeveria e Ilirisë gjatë pastrimit të fundit të sektorit financiar nga Banka Qendrore e Republikës së Ilirisë. Banka Zhvillimore sh.a nuk tregton drejtpërdrejt me banka të tjera të kontrolluara nga qeveria, por ka marrë marrë ëprsipër zhvillimin e shërbimit postar në pronësi shoqërore dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Ilirisë. Drejtorët e Bankës Zhvillimore sh.a janë të shqetësuar për vëllimin dhe koston e shpalosjes së interesave të palëve të ndërlidhura, sepse ato shtrihen teorikisht në të gjitha ndërmarrjet dhe bankat e tjera të kontrolluara nga qeveria e Ilirisë. Drejtorët kërkojnë këshilla të përgjithshme mbi natyrën dhe rëndësinë e dhënies së shënimeve shpjeguese të marrëdhënieve me palët e ndërlidhura dhe këshilla specifike për shpalosjen e marrëdhënieve të mësipërme në pasqyrat financiare.

**Kërkohe:**

**Këshilloni Drejtorët e kompanisë se si të trajtojnë transaksionin e mësipërm në pasqyrat financiare në përputhje me SNK 24 *Shpalosjet e palëve të ndërlidhuara*. (5 pikë)**

(c) SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, vlerësimet në kontabilitet dhe gabimet* përmban udhëzime për përdorimin e politikave kontabël dhe vlerësimet kontabël.

**Kërkohe:**

**Shpjegoni bazën mbi të cilën menaxhmenti i një entiteti duhet të zgjedhë politikat e tij kontabël dhe trego dallimin, me një shembull, midis ndryshimeve në politikat kontabël dhe ndryshimeve në vlerësimet kontabël. (5 pikë)**

**(d)** SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksion* përkufizon një transaksion pagese të bazuar në aksion si një transaksion në të cilin një entitet merr mallra ose shërbime nga një palë e tretë (duke përfshirë një punonjës) në një marrëveshje pagese të bazuar në aksione. SNRF 2 më tej përcakton një marrëveshje pagese të bazuar në aksion si një marrëveshje midis një entiteti dhe një pale të tretë që i jep të drejtën palës së tretë të marrë:

- Instrumentet e ekuitetit të entitetit (pagesat e bazuara në aksione të shlyera me ekuitet);
- Para te gatshme ose pasuri të tjera bazuar në çmimin e instrumenteve të ekuitetit të entitetit (pagesat e bazuara në aksione të shlyera me para).

Marrëveshjet e pagesave të bazuara në aksione shpesh i nënshtrohen kushteve të përfitimit të titullit të cilat duhet të plotësohen gjatë një periudhe të përfitimit të titullit.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni parimet e njohjes dhe matjes për pagesat e bazuara në aksione siç përcaktohen në SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione*. (5 pikë)**

**(Total 20 pikë)**

### 3.

#### a) Skema e pensioneve

Skema e përfitimeve të përcaktuara për vitin duhet të ishte regjistruar si më poshtë:

	<b>€ milion</b>
Neto detyrimi me 31 dhjetor 2021	120
Kontributet në para të pranuar	(100)
Neto kostoja financiare për vitin (€120 milionë x 5%)	6
Kostot aktuale të shërbimit	55
Neto humbja nga zvogëlimi i planit	11
Fitimi në rimatjen	<u>(9)</u>
<b>Neto detyrimi me 31 dhjetor 2022</b>	<b>83</b>

Përfitimet e paguara nuk ndikojnë në detyrimin neto të vitit. Meqenëse vetëm kontributet në para janë regjistruar për vitin, detyrimi neto duhet të rritet me €63 milionë (€83 milionë - €20 milionë (120 -100). €72 milionë duhet të shpenzohen në fitim ose humbje duke qenë kostoja e shërbimit komponenti (aktual dhe zvogëlimi i planit) plus hpenzimet e interesit €9 milion duhet të kreditohen në komponentë të tjerë të ekuitetit që është fitimi nga rimatja.

#### **Pasqura e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 - ekstrakt**

	<b>€ milionë</b>
Skema e përfitimeve të paracaktuara (€55 + €6 + €11)	(72)

#### **Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2022 - ekstrakt**

	<b>€ milionë</b>
Ekuiteti dhe detyrimet:	
TTGJ- komponenti i rimatjes	9
Detyrimet afatgjata:	
Rritja në obligimet e përfitimeve të paracaktuara	63

#### b)

Sipas SNK 24 *Shpalosjet e palëve të ndërlidhuara*, kërkohen dhënie informacionesh shpjeguese në lidhje me transaksionet e një entiteti me palët e lidhura. Palët e lidhura përfshijnë kompanitë prind, filialet, anëtarët e personelit drejtues kryesor të entitetit ose të një prindi të entitetit dhe skemat e përfitimeve të punonjësve. Aty ku ka pasur transaksione me palët e ndërlidhura gjatë periudhës, menaxhmenti shpalos natyrën e marrëdhënies, si dhe informacionin për transaksionet dhe saldo e papaguara, duke përfshirë zotimet, të nevojshme që përdoruesit të kuptojnë ndikimin e mundshëm të marrëdhënies në pasqyrat financiare. Shpalosjet bëhen sipas kategorisë së palës së lidhur dhe sipas llojit kryesor të transaksionit. Menaxhmenti shpalos që transaksionet me palët e lidhura janë bërë me kushte të barasvlefshme me ato që mbizotërojnë në transaksionet duarlibër vetëm nëse këto kushte mund të vërtetohen.

Subjektet e lidhura me qeverinë përkufizohen si subjekte që kontrollohen, kontrollohen bashkërisht ose ndikohen ndjeshëm nga qeveria. Kriza financiare në sektorin e shërbimeve financiare zgjeroi gamën e subjekteve që u nënshtrohen kërkesave të deklarimit të palëve të lidhura. Mbështetja financiare e ofruar nga qeveria për institucionet financiare në shumë vende nënkuptonte që kontrollet e qeverisë ndikuan ndjeshëm në disa prej atyre subjekteve.

Një bankë e kontrolluar nga qeveria, në parim, do t'i kërkohet të shpalosw detajet e transaksioneve, depozitave dhe zotimeve të saj me të gjitha bankat e tjera të kontrolluara nga qeveria dhe me bankën qendrore. Megjithatë, SNK 24 ka një përjashtim nga të gjitha kërkesat për shpalosje të SNK 24 për transaksionet ndërmjet entiteteve të lidhura me qeverinë dhe qeverisë, dhe të gjitha entiteteve të tjera të lidhura me qeverinë.

Banka Zhvillimore sh.a përjashtohet nga kërkesat për shpalosje në lidhje me transaksionet e palëve të lidhura dhe saldot e papaguara, duke përfshirë zotimet, në lidhje me sa vijon:

(a) një qeveri që ka kontroll, kontroll të përbashkët ose ndikim të rëndësishëm mbi entitetin raportues; dhe

(b) një entitet tjetër i cili është palë e ndërlidhur sepse e njëjta qeveri ka kontroll, kontroll të përbashkët ose ndikim domethënës si mbi entitetin raportues ashtu edhe mbi entitetin tjetër.

Këto shpalosje zëvendësohen me një kërkesë për shpalosje:

- Emri i qeverisë dhe natyra e marrëdhënies së tyre; dhe
- Natyrën dhe shumën e çdo transaksioni individualisht të rëndësishëm; dhe
- Shtrirja e çdo transaksioni kolektivisht të rëndësishëm në mënyrë cilësore ose sasiore.

c)

SNK 8 *Politikat e kontabilitetit, vlerësimet në kontabilitet dhe gabimet* kërkon që një entitet të përcaktojë politikën e kontabilitetit për t'u zbatuar për një transaksion ose ngjarje duke iu referuar çdo SNRF që zbatohet në mënyrë specifike për atë transaksion ose ngjarje. Kur nuk ka një SNRF specifike të zbatueshme, menaxhmenti pritet të përdorë gjykimin e tij në zbatimin e një politike të kontabilitetit e cila do të rezultojë në informacion që është i përshtatshëm dhe i besueshëm.

Në këtë, ata duhet të marrin në konsideratë kërkesat dhe udhëzimet në SNRF-të që kanë të bëjnë me çështje të ngjashme dhe të ndërlidhura, si dhe përkufizimet e Kornizës Konceptuale, kriteret e njohjes dhe konceptet e matjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

Politikat e kontabilitetit janë parimet, bazat dhe rregullat specifike që zbatohen në matjen dhe paraqitjen e informacionit financiar. Ndryshimet e politikës së kontabilitetit nuk janë shumë të zakonshme. Një shembull do të ishte një ndryshim nga metoda FIFO e vlerësimit të stoqeve në metodën mesatare të ponderuar - ky është një ndryshim në bazën e vlerësimit.

Një ndryshim i vlerësimit në kontabilitet është një ndryshim në mënyrën se si zbatohen këto parime dhe baza, i cili çon në një rregullim të ndonjë prej elementeve të identifikuar nga Korniza Konceptuale - pasuritë, detyrimet, të ardhurat ose shpenzimet. Një shembull do të ishte një ndryshim nga metoda lineare e zhvlerësimit në metodën e saldoshme. Në këtë rast politika kontabël është që pasutië afatgjata mbahen me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar, vlerësimi kontabël është mënyra se si llogaritet ai zhvlerësim.

d)

### Njohja

- Entiteti duhet të njohë [kontabilizojë] mallrat ose shërbimet e marra ose të përfutuara në transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione në kohën kur ai merr në dorëzim mallrat ose shërbimet.
- Mallrat ose shërbimet e marra ose të përfutuara në një transaksion të pagesës së bazuar në aksione duhet të njihen [kontabilizohen] si shpenzime me përjashtim të rasteve kur ato do të mund të njihen [kontabilizohen] si pasuri.
- Mallrat mund të konsumohen gjatë një periudhe kohore ose, në rastin e stokeve, të shiten në një datë të mëvonshme, në të cilin rast një shpenzim njihet kur mallrat konsumohen ose shiten.
- Entiteti duhet të njohë [kontabilizojë] një rritje përkatëse në ekuitet në rast se mallrat ose shërbimet janë përfutur si rrjedhojë e një transaksioni, pagesa e të cilit bazohet në aksione të shlyeshme me ekuitet, ose një detyrim në rast se mallrat ose shërbimet janë përfutur nga një transaksion, pagesa e të cilit bazohet në aksione të shlyeshme me para të gatshme.

### Matja

- Për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione të shlyera me ekuitet, entiteti do të matë mallrat ose shërbimet e marra dhe rritjen korresponduese të ekuitetit, drejtpërdrejt, me vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimeve të marra, përveç rasteve kur kjo vlerë e drejtë nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.
- Në qoftë se vlera e drejtë e mallrave ose shërbimeve të përfutuara nuk mund të matet me besueshmëri, entiteti duhet të masë vlerën e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me ekuitet duke iu referuar vlerës së drejtë të instrumenteve të ekuitetit të dhëna si kompensim.

### Transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me ekuitet

Kur pagesa për mallra ose shërbime është në formën e aksioneve ose opsioneve të aksioneve, vlera e drejtë e transaksionit - njihet në fitim ose humbje, e shpërndarë gjatë periudhës së përfitimit të titullit.

Nëse mallrat ose shërbimet merren në këmbim të aksioneve ose opsioneve të aksioneve, transaksioni kontabilizohet:

Debi	Shpenzimet/Pasuria
Kredi	Ekuiteti

SNRF 2 nuk përcakton se në cilën llogari të ekuitetit bëhet regjistrimi i kredisë. Është praktikë normale të kreditohet një komponent i veçantë i ekuitetit, kryesisht fitimet e pashpërndara kreditohen.

### Matja

Kur merret parasysh shpenzimi total në fitimi ose humbje, parimi bazë është që transaksionet e bazuara në aksione të shlyera me ekuitet maten me vlerën e drejtë.

Vlera e drejtë do të varet nga me kë bëhet transaksioni:

- Ekziston një supozim i kundërshtueshëm që vlera e drejtë e mallrave/shërbimeve të marra nga një palë e tretë mund të matet në mënyrë të besueshme.

Zakonisht nuk është e mundur të maten shërbimet e marra kur aksionet ose opSIONET e aksioneve janë pjesë e paketës së shpërblimit të punonjësve.

#### Transaksionet e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me para të gatshme

- Për transaksionet e pagesave të bazuara në aksione të shlyera me para të gatshme, entiteti do të matë mallrat ose shërbimet e blera dhe detyrimin e krijuar me vlerën e drejtë të detyrimit.

- Derisa detyrimi të shlyhet, entiteti do të rimasë vlerën e drejtë të detyrimit në fund të çdo periudhe raportuese dhe në datën e shlyerjes, me çdo ndryshim në vlerën e drejtë të njohur në fitim ose humbje për periudhën.

Nëse mallrat ose shërbimet merren në këmbim të shumave të parave të gatshme të lidhura me vlerën e aksioneve, transaksionet kontabilizohen:

Debi                      Shpenzimet/Pasuria

Kredi    Detyrimi

4.

a) Më 1 tetor 2021, Diana sh.a hyri në një marrëveshje në të cilën kontrakttoi të blinte \$100,000 nga një bankë brenda gjashtë muajsh me një normë të ardhshme prej €17/1\$. Marrëveshja ishte një mbrojtje kundër një zhvlerësimi të mundshëm të Euros pasi Diana sh.a planifikoi të importonte një makinë për qepjen e fustanave me një kosto prej \$100,000 në të ardhmen. Kursi i këmbimit në Kosovë më 1 tetor 2021 ishte €17/\$. Diana sh.a e bleu makinën e qepjes së fustanave më 31 mars 2022, me një kosto prej \$100,000 duke përdorur të ardhurat nga pagesat e marrëveshjes së blerjes së valutës. Kursi i këmbimit në Kosovë më 31 mars 2022 ishte €18/1\$ ndërsa më 31 dhjetor 2021, ishte €17.3/1\$. Makina e qepjes së fustanave zhvlerësohet për një jetë të dobishme prej pesë (5) vitesh në bazë lineare me një vlerë të mbetur zero. Drejtorët e kanë vlerësuar transaksionin për qëllime raportimi dhe kanë arritur në përfundimin e saktë se ai përbën një mbrojtje të rrjedhave të parasë të një transaksioni të ardhshëm shumë të mundshëm në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni drejtorëve të Diana sh.a se si duhet të kontabilizohen transaksionet e mësipërme në pasqyrat financiare të Diana sh.a për vitin deri më 31 dhjetor 2022 në përputhje me SNRF-të. (8 pikë)**

b) Më 1 janar 2022, Ginsburg sh.a emetoi 5 milionë nota të kreditit me vlerë nominale €10, normë të interesit prej 8%. Emetimi i këtyre notave u bë me një premi prej 5%. Notat e kreditit kanë një afat origjinal maturimi prej tre (3) vitesh dhe janë të riblershme në maturim në vlerë nominale. Kostot e transaksionit të shkatuara nga Ginsburg sh.a më 1 janar 2022 arritën në €100,000. Norma specifike e interesit të tregut për notat e kreditit (norma e interesit që pasqyron vlerësimin e kredisë së Ginsburg sh.a) ishte 6.16% më 1 janar 2022 ndërsa norma e përgjithshme e interesit të tregut për këtë lloj instrumenti ishte 8% në të njëjtën datë. Ginsburg sh.a emetoi notat e kreditit për të financuar koston e investimeve të cilat janë klasifikuar si pasurime vlerë të drejtë nepermjet fitimit ose humbjes (VDNFH). Rrjedhimisht, në korrigjimin e një mospërputhjeje të mundshme të matjes midis këtyre pasurive dhe notave të kreditit, Ginsburg sh.a i ka përcaktuar saktë notat e kreditit si një detyrim VDNFH në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Më 31 dhjetor 2022, norma specifike e interesit të tregut ishte 7.2% ndërsa norma e përgjithshme e interesit të tregut ishte 9%.

Viti	Norma e interesit				
	5%	6.16%	6.93%	7.2%	9%
1	0.9524	0.9420	0.9352	0.9328	0.9174
2	0.9070	0.8873	0.8746	0.8702	0.8417
3	0.8638	0.8358	0.8179	0.8117	0.7722

**Kërkohet:**

**Shpjegoju drejtorëve të Ginsburg sh.a se si duhet të kontabilizohen transaksionet e mësipërme në pasqyrat financiare të Ginsburg sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022 në përputhje me SNRF-të. (8 pikë)**



c) Gjatë vitit financiar që mbaroi në 31 dhjetor 2022, Cleopatra sh.a. emtoi dy instrumente financiare të përshkruara më poshtë:

- (i) Aksionet preferenciale të ri - bleshme me një normë të kuponit 8%. Aksionet janë të ribleshme në 31 dhjetor 2026 me një premi prej 10%
- (ii) Garantimi i kontratave me mundësi zgjedhjeje për blerjen e aksioneve për ekzekutivin e lartë. Kontratat me mundësi zgjedhjeje mund të ushtrohen nga 31 dhjetor 2025.

**Kërkohet:**

**Për secilin prej instrumenteve, identifikoni faktin nëse duhet të klasifikohet si borxh apo si ekuitet, duke shpjeguar arsyet se pse bëni këtë zgjedhje. Në secilin rast ju duhet t'i referoheni SNRF-ve përkatëse.**

**(4 pikë)**

**(Total: 20 pikë)**

a) Në përputhje me SNRF 9, kur një mbrojtje e rrjedhave të parasë rezulton në njohjen e një zëri jomonetar, fitimet dhe humbjet e rimatjes në instrumentin mbrojtës që janë brenda pjesës efektive të mbrojtjes duhet fillimisht të raportohen në TTGJ (zëra që do të rriklasifikohen në F/H) dhe rriklasifikohet me njohjen e elementit jomonetar duke kompensuar fitimin e akumuluar në TTGJ kundrejt vlerës fillestare kontabël të elementit jomonetar.

Kontrata e valutës për të ardhmen është një instrument derivativ dhe për këtë arsye do të klasifikohet si zë VDTTJ dhe do të matet normalisht në VD çdo datë raportimi. Megjithatë, vetëm fitimet dhe humbjet jashtë pjesës efektive të mbrojtjes do të raportohen menjëherë në F/H

Shumat e mëposhtme do të raportohen në PF për vitin deri me 31 dhjetor 2022:

<b>Kontrata e valutës për të ardhmen</b>	<b>€'milione</b>
Pasuri me 1 janar 2022 (17.3-17) x 100,000	0.03
Përfitimi nga rimatja e raportuar ne TTGJ për v/p me 31 dhjetor 2022 (saldo)	<u>0.07</u>
Pasuri me 31 mars 2022 (18.-17) x 100,000	0.10

<b>b) Fabrika dhe paisjet</b>	<b>€'milione</b>
Kosto e blerjes 31 mars 2022 \$100,000 x 18	1.8
Minus rriklasifikimi i përfitimit të akumuluar në kontratën 100,000 x (18-17)	<u>(0.1)</u>
Vlera bartëse fillestare e paisjes me 31 mars 2022	1.7
Zhvlerësimi për v/p me 31 dhjetor 2022 17/5 x 9/12	<u>(0.3)</u>
Vlera bartëse e paisjes me 31 dhjetor 2022	1.4

**b)**

Një instrument i klasifikuar si VDNFH në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare* do të matet fillimisht me FV duke përjashtuar kostot e transaksionit. Kostot e transaksionit shpenzohen në F/H për periudhën kur është lidhur kontrata. Më pas, instrumenti do të rimatet në VD çdo datë raportimi me fitime dhe humbje të raportuara kryesisht në F/H. Megjithatë, për detyrimet jo derivative të përcaktuara si VDNFH, çdo fitim ose humbje nga rimatja që rrjedh nga ndryshimet në aftësinë kreditore të entitetit raportues duhet të raportohet në TTGJ.

i) Në PPF me 31 dhjetor 2022, notat e kreditit raportohen në VD të llogaritura si vlera e tanishme e rrjedhave monetare të detyrimit të ardhshëm të skontuara me normën aktuale të interesit specifik të tregut të entitetit si më poshtë:

	<b>€'m</b>
Interesi i ardhshëm ((8% x €50,000,000 x (0.9328+ 0.8702)	7.21
Kryegjëja (€10 x €5,000,000 x 0.8702)	<u>43.51</u>
VD që duhet te raportohet në vlerën bartëse në PPF me 31 dhjetor 2022.	50.72

ii) Shumat që duhet te raportohet në PFH&TTGJ me 31 dhjetor 2022:

€'milionë

Në F/H:

Kosto e transaksionit	(0.1)
Kosto financiare (6.16% x €5,000,000 x €10 x 1.05)	(3.23)
Përfitimet e rimatjes (Llogaritjet)	<u>0.76</u>
	(2.57)
Përfitimet e rimatjes në TTGJ (1.01-0.76)	0.25

Llogaritjet - Fitimi/humbja nga rimatja në detyrimin e VDNFH

€'milionë

VD me 1 janar 2022 (€5,000,000 x €10 x 1.05)	52.5
Kosto financiare v/p 31 dhjetor 2022 (€52,500,000 x 6.16%)	3.23
Minus paraaja e paguar 31 dhjetor 2022 (8% x €5,000,000 x €10)	<u>(4)</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2022 para rimatjes	51.73
Total fitmi nga rimatja (saldo balancuese)	<u>(1.01)</u>
VD për tu raportuar me 31 dhjetor 2022	50.72

Fitimi/humbja për tu raportuar në F/H:

Vlera bartëse para rimatjes	51.73
Fitimi për tu raportuar në F/H (saldo balancuese)	<u>(0.76)</u>
VD e pritshme me 31 dhjetor 2022 pa ndryshim në rejtingun kreditor (L)	50.97

VD e pritshme me 31 dhjetor 2022 pa ndryshim në rejtingun kreditor

Norma e interesit e pritshme pa ndryshim në rejtingun kreditor 9%/8% x 6.16% = 6.93%

VD e pritshme me 31 dhjetor 2022

€'milionë

Interesi i ardhshëm (8% x €10 x €5,000,000 x (0.9532 +0.8746))	7.24
Kryegjësja (€10 x €5,000,000 x 0.8746)	<u>43.73</u>
VD e pritshme me 31 dhjetor 2022	50.97

c)

**(i) Borxhi.** Aksionet preferenciale kërkojnë shpërndarje të rregullta [të dividendëve] ndaj mbajtësve të tyre por ajo që është më e rëndësishmja është që këto aksione kanë karakteristika të instrumenteve të borxhit meqenëse aksionet janë të ri-bleshme. Në këtë mënyrë në përputhje me SNK 32 *Instrumentet financiare: paraqitja*, ato duhet të klasifikohen si borxhe.

**(ii) Ekuiteti.** Në përputhje me SNRF 2 *Pagesat e bazuara mbi aksione* garantimi i kontratave me mundësi për blerjen e aksioneve duhet të regjistrohet si ekuitet në pasqyrën e pozitës financiare. Kjo është një metodë alternative e pagesës me para të gatshme për ofrimin e shërbimeve nga ana e drejtorëve.

5.

a) Më 1 mars 2022, Nightingale sh.a u ofron të gjithë aksionerëve të saj të zakonshëm të drejtën për të blerë 1 aksion të zakonshëm për çdo 4 aksione të zakonshme që ata zotërojnë, me 30% zbritje ndaj vlerës së drejtë (çmimi i tregut).

Çmimi i tregut për aksion më 10 mars 2022 është €10 dhe kjo është dita e fundit kur aksionet tregtohen me të drejta (jo pa të drejtat).

Kapitali aksionar i Nightingale sh.a përbëhet nga 100,000 aksione të zakonshme para emetimit të të drejtave.

Data e fundit e ushtrimit të të drejtave është 1 prill 2022 dhe të gjitha të drejtat janë ushtruar.

Fitimi i Nightingale sh.a-së që i atribuohet aksionerëve të zakonshëm ishte €200,000 në vitin 2021 dhe €250,000 në vitin 2022.

**Kërkohet:**

**Llogaritni FPA-në e thjeshtë për vitin 2022 dhe informacionin krahasues për vitin 2021.**

**(5 pikë)**

b) SNK 34 *Raportimi i ndërmjetëm financiar* rekomandon që entitetet të përpilojnë raporte të ndërmjetme financiare, dhe për entitetet që publikojnë raporte të tilla, parashtron parimet dhe udhëzimet për përpilimin e tyre. SNK 34 parashtron se ndryshimet që janë relativisht të vogla prej pasqyrave financiare vjetore të periudhës së fundit, nuk duhet të përfshihen në raportet e ndërmjetme

**Kërkohet:**

i) **Tregoni perkufizimet e 'Periudha e ndërmjetme' dhe të 'Raport i ndërmjetëm financiar' sipas SNK 34 Raportimi i ndërmjetëm financiar.** **(4 pikë)**

ii) **Tregoni elementet që duhet të përfshijnë shënimet shpjeguese të raporteve të ndërmjetme (me përjashtim të rasteve kur informacionet paraqiten diku tjetër në raport).** **(6 pikë)**

c) Tregtimi i aksioneve duke poseduar informacione të brendshme është tregtimi i letrave me vlerë prej dikujt i cili posedon informacione të brendshme si një i brendshëm, ndërsa çmimi i letrave me vlerë ndikohet prej informacioneve të tilla. Në këtë mes përfshihen edhe transaksionet që kryhen jashtë tregut midis 'ndërmjetësuesve profesionalë' ose transaksionet që kanë të bëjnë me ta, dhe jo vetëm transaksionet që kryhen në një bursë të caktuar.

**Kërkohet:**

**Sqaroni shkurtimisht se çfarë mund të konsiderohen informacione të brendshme. (5 pikë)**

a)

Data	(A) Ndarja kohore (nr. i muajve/12)	(B) Nr. i aksioneve	(C) Faktori bonus	(D=B*C) Nr i korigjuar i aksioneve	(E=A*D) Numri mesatar i ponderuar i aksioneve
1 janar- 31 mars	3/12	100,000	1,064	106,400	26,600
1 prill - 31 dhjetor	9/12	125,000	1,000	125,000	93,750
<b>Totali</b>					<b>120,350</b>

Viti	(A) Fitimet - E (tablea 1)	(B) Numri mesatar i ponderuar i aksioneve	(C = A/B) FPA
2021	200,000	106,400	1,880
2022	250,000	120,350	2,077

Faktori bonus

Çmimi teorik pa të drejta:

Aksionet e reja =  $100,000 / 4 \times 1 = 25,000$

Arkëtimet nga emetimi =  $25,000 \times \text{€}10 \times 70\% = \text{€}175,000$

Numri i ri i aksioneve = 125,000

Çmimi teorik pa të drejta =  $(100,000 \text{ aksione} \times \text{€}10 + 175,000 \text{ per } 25,000 \text{ aksionet e reja}) / 125,000 \text{ aksione} = \text{€}9.4$

Fraksioni bonus =  $\text{€}10 / \text{€}9.4 = 1.064$

b)

i)

SNK / IAS 34 përdor përkufizimet e mëposhtme:

- *Periudha e ndërmjetme* është një periudhë raportuese financiare më e shkurtër se një vit financiar.
- *Raport i ndërmjetëm financiar* do të thotë një raport financiar i cili përmban ose një komplet të plotë të pasqyrave financiare (siç përshkruhet në SNK 1) ose një komplet të pasqyrave të përmbledhura financiare (siç përshkruhet në këtë standard) për një periudhë të ndërmjetme.

ii)

SNK / IAS 34 parashtrohet se ndryshimet që janë relativisht të vogla prej pasqyrave financiare vjetore të periudhës së fundit, nuk duhet të përfshihen në raportet e ndërmjetme. Megjithatë,

shënimet shpjeguese të raporteve të ndërmjetme duhet të përfshijnë elementet e mëposhtme (me përjashtim të rasteve kur informacionet paraqiten diku tjetër në raport):

- ✓ Një deklaratë që tregon se për pasqyrat e ndërmjetme janë përdorur të njëjtat politika e kontabilitetit dhe metodat të llogaritjes si ato të përdorura për pasqyrat financiare vjetore të periudhës së fundit. Në qoftë se jo, duhet të përshkruhet natyra e diferencave dhe efekti i tyre. (Politikat e kontabilitetit për përgatitjen e raporteve të ndërmjetëm duhet të ndryshojnë nga ato të përdorura për pasqyrat financiare vjetore të periudhës së fundit vetëm në ato situata kur ka pasur ndryshime në politikat e kontabilitetit që nga fundi i vitit të kaluar financiar, dhe politikat e reja duhet të zbatohen për pasqyrat financiare vjetore të periudhës aktuale financiare.)
- ✓ Komentet shpjeguese mbi sezonalitetet ose 'natyrën ciklike' të veprimtarive [operacioneve] në periudhën e ndërmjetme. Për shembull, në qoftë se një kompani realizon shumicën e fitimeve të saj vjetore në gjysmën e parë të vitit, për arsye se shitjet janë shumë më të larta gjatë gjashtë muajve të parë, raporti i ndërmjetëm për gjysmën e parë të vitit duhet të shpjegojë këtë fakt.
- ✓ Natyrën dhe vlerat monetare të zërave ose ngjarjeve të ndodhura gjatë periudhës së ndërmjetme të cilët kanë pasur ndikim mbi pasuritë, detyrimet, kapitalin, të ardhurat neto ose rrjedhjet e parasë së gatshme, e të cilat janë të pazakonshme, për sa i takon natyrës, shpeshësisë së ndodhjes ose madhësisë së tyre.
- ✓ Emetimet ose ri – blerjet [nga vetë kompania] e instrumenteve të ekuitetit ose të borxhit
- ✓ Natyrën dhe vlerat monetare të të gjitha ndryshimeve në vlerësimet e vlerave monetare të raportuara në një raport të ndërmjetëm më të hershëm gjatë vitit financiar, ose gjatë viteve të mëparshme financiare në qoftë se këto të fundit kanë ndikim mbi periudhën e ndërmjetme aktuale.
- ✓ Dividendët e paguar për aksionet e zakonshme dhe dividendët e paguar për aksionet e tjera
- ✓ Rezultatet për segmentet afariste ose segmentet gjeografike të entitetit
- ✓ Të gjitha ngjarjet domethënëse që nga fundi i periudhës së ndërmjetme
- ✓ Efekti i blerjes ose shitjes së filialeve gjatë periudhës së ndërmjetme
- ✓ Të gjitha ndryshimet e rëndësishme në detyrimet kontingjente ose në pasuritë kontingjente që nga data e pasqyrës së pozitës financiare të vitit të fundit

Në të njëjtën kohë entiteti duhet të shpjegojë faktin që raporti i ndërmjetëm është përpiluar në përputhje me SNK 34 *Mbi Raportimin e Ndërmjetëm Financiar*.

c)

**Informacionet e brendshme** janë ato “informacione të cilat shkaktojnë ndryshime në çmime” dhe që kanë të bëjnë me një çështje të caktuar, vetëm të letrave me vlerë të cilave iu ndryshon çmimi dhe jo të letrave me vlerë në përgjithësi. Këto informacione mund të jenë specifike ose të sakta dhe, në qoftë se bëhen publike, me mundësi të madhe kanë një efekt të rëndësishëm mbi çmimin e letrave me vlerë në fjalë. Disa nga informacionet e brendshme materiale përfshijnë dhe nuk kufizohen në sa vijon:

- Regjistrimet e falimentimit
- Ndryshim në bordin e drejtorëve të kompanisë, firmën publike të kontabilitetit ose zyrtarët e korporatës

- Informacion në lidhje me aktivitetet e një kompanie të tilla si planet e riblerjes së aksioneve, ndryshimi i dividendëve, ndarjet e aksioneve, ankandi, një ofertë për blerje, konsolidimi, vendosja private ose oferta publike, etj.
- Ri-publikimi i pasqyrave financiare
- Fitimet e parashikuara që nuk janë në përputhje me pritjet
- Shitja ose blerja në pritje e një pasurie, ose porosi të rëndësishme
- Zhvillimet e informacionit në një mosmarrëveshje ligjore të vazhdueshme që përfshin një firmë